

# KARTA E TE DREJTAVE TË KANDIDATIT

## ÇFARË DUHET TË PRISNI NGA NJË FIRMË PROFESIONALE SI AIMS

Kjo kartë e të drejtave është e publikuar në webin e AIMS International Albania (AIMS). Nëse ju jeni një kandidat që aplikoni për tu përfshirë në një proces rekrutimi lexoni me vëmendje këtë kartë të bërë publike.

Konsulentët e AIMS përpiqen t'u ofrojnë kandidatë të kualifikuar për pozicione menaxheriale klientëve të tyre, të cilët duan të punësojnë në pozicione të nivelit të lartë dhe marrëdhëniet kontraktuale lidhen vetëm ndërmjet AIMS dhe klientit. Megjithatë, konsulentët tanë ndërtojnë marrëdhënie profesionale dhe etike edhe me kandidatët, marrëdhënie e cila mund të vazhdojë për vite të tëra. *Kodi i etikës së AIMS* përcakton shprehimisht se këto marrëdhënie duhet të karakterizohen nga *ndershmëria, objektiviteti, korrektësia dhe ruajtja e konfidencialitetit*. Ne besojmë se suksesi ynë varet nga marrëdhënia trepalëshe, përmes të cilës kandidati, klienti dhe AIMS i njohin plotësisht të drejtat, detyrat dhe detyrimet ndaj njëri-tjetrit gjatë procesit të rekrutimit. Në marrëdhënie me AIMS, çdo kandidat gëzon të drejtën për:

### I. Konfidencialitet

Kur hyni në shortlistën e kandidatëve të AIMS, në një fare mase ju rrezikoni me punëdhënësin tuaj egzistues. Për këtë arsye, ju sigurohet ruajtja e konfidencialitetit në nivelin më të lartë nga ana jonë dhe e firmës kliente. Në mënyrë që të ruhet konfidencialiteti juaj, konsulenti i AIMS duhet:

- Të marrë miratimin tuaj para se t'ju prezantojë dhe t'i raportojë firmës kliente për ju.
- Të kontaktojë direkt me ju gjatë gjithë procesit.
- Të mos kontaktojë personat që keni dhënë për referencë pa lejen tuaj.
- Të mos diskutojë për mundësinë tuaj të rekrutimit me asnjë jashtë AIMS, dhe të sigurohet që të gjithë punonjësit tanë i binden të njëjtave rregulla.
- Të kujdeset që edhe klienti të ruajë konfidencialitetin tuaj.

Është e rëndësishme të kuptoni që për të hyrë në listën e kandidatëve, duhet që konsulenti të ketë kryer vlerësimin fillestar mbi përshatshmërinë tuaj për pozicionin dhe që ju të keni

shprehur interesim për të. Në rast se një nga këto dy kritere mungon, ju nuk mund të konsideroheni kandidat për pozicionin. Megjithatë, edhe nëse pozicioni për të cilin jeni thirrur nuk ju përshtatet, mundet ende të përfitoni nga bisedat me konsulentët tanë ku mund të merrni informacionet më të fundit rreth tregut të punës në lidhje me aftësitë dhe eksperiencën tuaj. Kandidatët që nuk përzgjidhen në një projekt kërkimi mund të përzgjidhen në një tjetër.

### Informacion transparent mbi Projektin

Në mënyrë që të merrni vendimin e duhur, ju duhet sa më shumë informacion rreth pozicionit të punës dhe firmës punëdhënëse. Kjo padiskutim nënkupton informacion të plotë dhe të hapur në lidhje me:

- Llojin dhe kërkesat e pozicionit të punës
- Paketën e kompensimit
- Vendndodhjen e punës
- Kompaninë kliente

Sidoqoftë, kini parasysh se gjatë bisedës së parë kur ende vlerësohet nëse jeni ose jo kandidat i mundshëm për këtë pozicion, konsulenti ynë nuk është i detyruar t'ju zbulojë informacione konfidenciale rreth pozicionit të punës dhe kompanisë kliente. Vetëm pasi të jeni identifikuar dhe përzgjedhur si kandidat për pozicionin e punës, konsulenti mund t'ju japë informacion më të detajuar. Edhe atëherë, ka raste kur disa informacione duhet të mbeten konfidenciale deri në përfundim të procesit dhe të zbulohen më vonë.

### III. Komunikim në Kohë

Përfundimi i procesit të rekrutimit shpesh mund të dojë shumë kohë (nga disa javë në disa muaj), dhe shumë hapa nga kontakti i parë deri te marrja përfundimtare në punë e kandidatit të suksesshëm. Pasi bëheni kandidat aktiv në një projekt specifik, ne do të komunikojmë me ju në kohën e duhur gjatë secilës fazë të procesit.

#### IV. Informim mbi reagimin e klientit

Duke njohur mirë pozicionin e punës dhe nevojat e klientit, konsulenti do t'ju japë një vlerësim të hapur mbi përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë tuaj për pozicionin. Në rast se gjatë procesit klienti vendos të mos vazhdojë me kandidaturën tuaj, konsulenti do t'ju japë shpjegimin më të plotë të mundshëm rreth vendimit të klientit.

#### V. Trajtim Profesional

Konsulentët tanë veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet që zbatohen në procesin normal të rekrutimit. Përveç kësaj, pa asnjë dallim, ata tregojnë një nivel të lartë profesionalizmi me secilin kandidat. Trajtimi profesional do të thotë që konsulenti:

- Ka kuptuar siç duhet pozicionin e punës dhe kërkesat e klientit për këtë pozicion.
- Kryen një intervistë dhe procedurë vlerësimi të organizuar dhe të menduar mire.
- Respekton orarin dhe është i përgatitur për të gjitha takimet.
- Tregon se ka njohuri të thellë mbi tregun dhe klientin.
- U përgjigjet të gjitha pyetjeve tuaja në mënyrë të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

#### VI. Informim mbi Proçesin

Si kandidat i shortlistës, ju duhet të dini çfarë ndodh në çdo fazë të tij. Për shembull, kur mendohet të zhvillohen intervistat e para? Nëse ndërmerrni hapin e parë, çfarë vjen më pas?

Konsulentët e AIMS do t'ju ofrojnë me shumë kënaqësi këtë informacion. Në mënyrë të veçantë, këto janë pyetjet që duhet të bëni në çdo fazë të procesit:

- Sa kohë zgjat?
- Me kë do të takoheni para se të merret vendimi?
- Me çfarë afatesh kohore po punon klienti?
- Cili është hapi tjetër?

## VII. Respekt për Kohën dhe Pozicionin Tuaj të Punës

Konsulenti i AIMS është i ndërgjegjshëm për kohën dhe vëmendjen që kërkon pozicioni i punës tuaj egzistuese. Gjatë caktimit të takimeve dhe intervistave, konsulenti i kërkimit dhe klienti do të tregojnë respektin maksimal për kohën, pozicionin tuaj të punës dhe përgjegjësitë ligjore që keni ndaj punëdhënësit tuaj egzistues.

## VIII. Përputhshmëri Ndërmjet AIMS dhe Klientit

Konsulenti i AIMS dhe klienti duhet të përpiqen të jenë në të njëjtën gjatësi vale përsa i përket informacionit që ju japin. Duhet të keni parasysh që ndonëse konsulenti i AIMS përfaqëson klientin, ai nuk kontrollon gjithë komunikimin e klientit me ju gjatë procesit. Në rast se ndodhin ndryshime që bien ndesh me informacionin e dhënë nga konsulenti i AIMS duhet të kërkoni sqarime nga klienti ose konsulenti.

## IX. Marrëdhënie Besimi

Nëse konsulenti sillet në pajtim me këto parime bazë, natyrisht që mes jush do të krijohet një marrëdhënie besimi. Në të kundërt, nëse për çfarëdo arsye ndjeni se nuk mund t'i besoni konsulentit apo klientit, jeni të mirëpritur të tërhiqeni nga procesi. Kini parasysh se përpjekjet e konsulentëve tanë synojnë më shumë se plotësimin e vendeve të punës për klientët; ata duan t'ju ndihmojnë të merrni vendimin më të mirë për veten, familjen dhe karrierën tuaj.

## X. Kohë të Mjaftueshme

Vendimet më të mira ndodhin kur kandidati ka kohën e mjaftueshme për të marrë një vendim të matur e të studiuar. Për këtë arsye, konsulenti i AIMS nuk do t'ju shtyjë asnjëherë të merrni sa më shpejt një vendim apo t'ju vërë nën presion për të pranuar ofertën. Sidoqoftë, konsulenti do t'ju mbajë të informuar rreth afateve të përcaktuara nga klienti dhe pasojave për mosmarrjen e vendimit para afatit.